



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:042655

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760160

KPPP.nr.1476/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “B.S.M.” BI, me emër tregtar NTSH “Te Sya”, me numër unik identifikues 810664898, me seli në Ferizaj të cilin e përfaqëson avokati Xhemajl Ahmeti, kundër debitorit “Lunari Company” SHPK me numër unik identifikues 810186157, me seli në fshatin “Komogllavë-Ferizaj”, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit 16/22 të datës 08.02.2022, të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Mubarak S. Shumolli, me seli të zyrës në Ferizaj, jashtë seancës me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Lunari Company” SHPK me numër unik identifikues 810186157, me seli në fshatin “Komogllavë-Ferizaj”, i paraqitur kundër Urdhrit P.nr. 16/22 të datës 08.02.2022, të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Mubarak S. Shumolli, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr. 16/22 të datës 08.02.2022 duke vepruar sipas propozimit të kreditorit e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës numër 33 e datës 19.08.2019 dhe faturës me numër 103 e datës 24.12.2020 me të cilat ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga

faturat më sipër, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrimit t'i paguajë kreditorit shumën prej 1,353.30 Euro, me kamatën referente si pjesë e kamatës ligjore (lartësinë e të cilës BQK e publikon në bazë të rregullt gjashtëmujore sipas Ligjit nr.05/L-110 për Kamatëvonesa në Transaksione Tregtare) duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrimit të Përmbartuesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim duke shtuar se në bazë të faturave me anë të së cilave është iniciuar procedura përmbartimore, fatura me numër 33 e datës 19.08.2019 dhe fatura me numër 103 e datës 24.12.2020, produktet apo malli i vërtetuar në këto fatura nuk është pranuar nga ana e debitorit asnjëherë dhe se nuk mundë të paguajë për një mall apo shërbim të cilin nuk e ka pranuar.

I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, dhe të anulohet në tërësi urdhri përmbartimor i Përmbartuesit Privat.

Ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori, në përgjigje në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe se i njëjti ka theksuar se debitori me parashtrimin e prapësimi ka për qëllim vetëm prolongimin e çështjes përmbartuese sepse pretendimi i debitorit se nuk ka pranuar mallin është i pabazuar për faktin se të njëjtat fatura janë të nënshkruara nga ana e debitorit dhe se nuk është kontestuar asnjëherë fakti se produktet janë pranuar në momentin e pranimit të mallit. Ka shtuar se faturat i përmbajnë të gjitha elementet ligjore për përmbartim ashtu siç parashihet me dispozitat e procedurës përmbartimore.

Ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor si dhe ta detyrojë palën debitore që t'i paguajë shpenzimet procedurale. Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërkaq me paragrafin 3 të po të

njëjtë nën, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm-fatura me numër faturës nr.33 e datës 19.08.2019 dhe fatura me numër 103 e datës 24.12.2020 në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtjesore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat me numër 33 e datës 19.08.2019 dhe fatura me numër 103 e datës 24.12.2020 i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se nuk ka pranuar mallin i cili evidentohet në faturat e lartcekura, mirëpo në të njëjta fatura është e vendosur edhe vula me nënshkrimin e debitorit gjë që vërteton faktin se malli i përshkruar si në fatura është pranuar nga ana e debitorit.

Bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1476/23me datë 29.05.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.